



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2016

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI B

Lënda: Letërsi e thelluar

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 40 pikësh.
- Testi ka 20 pyetje. 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Kadare****E penguara**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë

Pyetja 6 **3 pikë**

- Atmosfera vjen e zyrtë, mbyttëse. Krahasimi i makinave me rrëshqanorë të heshtur pa gjak, krijon imazhin e një qyteti të tkurrur nga frika.
- **Natyra e shtetit:**

Përgjigje e plotë

- Izolimi i Lindës dhe familjes së saj, mohimi i së drejtës për të shkelur në Tiranë (internimi); rregullat e internimit, oraret që duhet të zbatoheshin pasi kontrolloheshin nga shteti; burgu i përjetshëm ose vdekja, nëse rregullat shkeleshin; shpronësimi i “armiqve të shtetit”; mungesa e së drejtës për të pasur TV, të gjitha këto dëshmojnë për *naturën e shtetit diktatorial* në Shqipërinë e asaj kohë, ku individi shtypej e izolohej nga shteti i cili ishte dhunuesi më i ashpër i të drejtave themelore të tij.

Përgjigje e pjesshme

- Raportet shtet-individ janë raporte dhune, tjetërsimi, mohimi të të drejtave më themelore të njeriut.

1 pikë Nëse konstaton atmosferën e fragmentit, e cila ndihmon në përcaktimin e marrëdhënieve shtet-individ.

DHE

2 pikë Nëse analizon në **mënyrë të plotë** natyrën e marrëdhënieve midis shtetit dhe individit.

OSE

1 pikë Nëse analizon në **mënyrë të pjesshme** natyrën e marrëdhënieve midis shtetit dhe individit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 7 **4 pikë****Ç'përfaqëson Tirana për heroinën kryesore?**

- Tirana është identiteti i Linda B. Tirana është bota e gjallë, është vetë jeta. Tirana i jep kuptim ekzistencës së saj. Kryeqyteti i jep jetë fantazisë, imagjinatës së saj, i shton ngjyra varfërisë emocionale dhe shpirtërore që e rrethon në provincën ku ajo jeton.

Ilustrime:

- *Nuk kishte njohur njeri, që pa qenë kurrë në një qytet, ta donte aq marrëzishëm atë. E njihte Tiranën më mirë se vetë kryeqytetasit.*
- *Nga reportazhet, lajmet dhe pëshpërimat që qarkullonin, njihte sheshet, kinematë, kafenetë. Nganjëherë pyeste për gjëra që s'të shkonte mendja.*
- *S'ishte e vështirë të kuptohej se Tirana e saj kishte pasur nevojë për një njeri.*
- *Nganjëherë i zbukuroja gjërat, i shtoja dritat, dyert prej qelqi, lartësinë e ndërtesave që të mos zhgënjehej. E dija që i shkruante në ditar, bashkë me përshtypjet nga leximet ose dramat e dëgjuara në radio.*

Ç'përfaqëson provinca?

- Provinca është mungesa e lirisë, mungesa e frymëmarrjes. Provinca përfaqëson gjithçka të mohuar: lirinë e mendimit dhe të lëvizjes.

Ilustrime

- *rregullat e internimit: nga paraqitja në orën e caktuar të pasdites në polici, gjer te dënimet në rast ikjeje pa leje. Për çdo qytet të afërt kishte dënim të caktuar. Për të largëtit dyfish. Për kryeqytetin shumë më tepër: burg i përjetshëm ose vdekje.*

2 pikë Nëse tregon ç'përfaqëson Tirana për heroinën bashkë me ilustrimet përkatëse.

DHE

2 pikë Nëse tregon ç'përfaqëson provinca për heroinën bashkë me ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 8 **4 pikë****➤ Titulli**

- **Ana gjuhësore:** *E penguara-* rrënja *peng*.
- **Ana stilistike:** fjala funksionon *si epitet* për Linda B.

Përfytyrimet:

- a) Duket qartë se Linda *pengohet* të shkojë në qytetin e saj të ëndërruar, Tiranën. Shteti diktatorial ia *pengon* asaj të drejtën e lëvizjes së lirë si njeri i lirë.
- b) Nga ana tjetër rrënja e fjalës *peng-* të zgjon një përfytyrim të ri. Linda B. është “marrë peng” në këtë rast nga provinca ku jeton. Ajo është peng i provincës, peng i diktaturës. Përmes këtij akti të *pengmarrjes* shteti diktatorial ushtron presionin e tij ndaj qytetarit. Në këtë përjasje kryeqyteti mbetet ëndrra përballë zhgjendrrës (provincës)

2 pikë Nëse analizon mbështetur në anën gjuhësore dhe stilistike titullin e veprës.

DHE

2 pikë Nëse shpjegon dy përfytyrimin që krijohen për heroinën nisur nga titulli i veprës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 **3 pikë****➤ Ç’përfaqëson për Lindën?**

- Rudian Stefa është një artist i dallueshëm nga mjedisi.

Në sytë e Lindës ai ishte i vetmi që mund të mbushte zbrazëtinë e krijuar tek ajo nga mungesa e Tiranës; ai ishte kuptimi i ekzistencës së saj:

“E ndiqte me vëmendje çdo fjalë tënden, çdo lëvizje të duarve, nervozizmin, që një çast mezi e mbajte përballë gazetarit. Kishte në fytyrë një si mahnitje, përzier me vuajtje ose, më saktë, merak. Kur intervista mbaroi, sytë i ndritnin dhe me zë të ulët tha: ai është ndryshe, në çdo gjë”.

➤ Simbolika që mbart

Figura e Rudian Stefës fiton edhe kuptim simbolik: është simbol i ndikimit të artit të vërtetë tek njeriu.

➤ Ngjashmëria me Orfeun

Në këtë rast arti i tij merr fuqinë e artit të Orfeut, i cili me muzikën e tij frymëzonte shpirtërat e të gjallëve, por edhe të të vdekurve. Kjo simbolikë vjen e përforcohet në momentet e fundit të librit kur Rudiani (Orfe), nuk kthen kokën të shohë Euridikën (imazhin e Lindës) nga frika mos e humbet atë ndjesi.

1 pikë Nëse shpjegon se ç’përfaqëson ky artist për Linda B.

DHE

1 pikë Nëse tregon simbolikën që mbart figura e Rudian Stefës.

1 pikë Nëse shpjegon ngjashmërinë me Orfeun.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II**Fatos Kongoli****Ne të tre**

Pyetja 10	D	1 pikë
Pyetja 11	B	1 pikë
Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë

Pyetja 15 **3 pikë**➤ **Si shfaqet dashuria:**

Është dashuri e brishtë. Është dashuri romantike edhe pse fjalët që i thonë njëri-tjetrit janë të thjeshta dhe pa ngjyresa romantike (skena e takimit në shtëpinë e Fredit).

➤ **Raporti me mjedisin:**

Dashuria midis dy të rinjve shfaqet e pambrojtur nga ambicia dhe egoizmi apo dhuna e mjedisit shoqëror dhe familjar (frika e Inës nga Ylli dhe tronditja e Fredit nga Sherifi dhe Ylli apo ankthi dhe pritja për reagimin e familjes së Inës në raport me këtë dashuri).

OSE

Mjedisi nuk e pranon dashurinë e tyre. E kundërshton atë.

1 pikë Nëse tregon si shfaqet dashuria midis dy të rinjve.

DHE

1 pikë Nëse tregon raportin që ka kjo dashuri me mjedisin rrethues.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e shoqërojnë me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 16 **1 pikë**

➤ Natyra e Fredit: e tërhequr, e përmbajtur (ai ka një numër shumë të paktë miqsh).

1 pikë Nëse tregon natyrën e Fredit, nisur nga fjalia e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **2 pikë*****Përgjigje e plotë***

- Natyra e tërhequr e Fredit lidhet me fëmijërinë e tij: humbjet dhe mungesat familjare dhe natyrë e ndryshme nga të tjerët.

OSE

- I rritur vetëm nga nëna, pa e njohur babanë, i përfshirë me ndrojtje në rrethet shoqërore; më pas me vdekjen e nënës, shumë ndryshe nga të tjerët; i dhënë pas librave, por i detyruar të punojë për të mbajtur veten. Pak i shoqërueshëm pasi i shmangej vetë kontakteve me mjedisin.

Përgjigje e pjesshme

- Natyra e tij lidhet me mënyrën se si është rritur.

OSE

- Ka lidhje me fëmijërinë e tij.

2 pikë Nëse tregon në **mënyrë të plotë** si ka ndikuar e kaluara në natyrën e tij.

OSE

1 pikë Nëse tregon në **mënyrë të pjesshme** si ka ndikuar e kaluara në natyrën e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 18 **1 pikë****➤ Tipare të stilit:**

- Personazhe të zakonshëm;
- Ngjarjet sillen nga perspektiva e shikimit të tre shokëve (Mirit, Inës dhe Fredit), të cilët paraqesin imazhin e vet në raport me ngjarjet (*p.sh: në këtë rast, në fragment, ngjarjet vijnë nga këndvështrimi i Fredit*);
- Gjuha është e gjallë dhe dialogët janë të zhdërvjellët;
- Gjuha është e jetës së përditshme, fjalor i thjeshtë, i zhveshur nga përshkrimi;
- Stili është lakonik;
- Ndërthuren natyrshëm dialogu me monologun;
- Personazhet karakterizohen përmes gjuhës dhe përshkrimit të narratorit.

1 pikë Nëse identifikon në fragmentin e dhënë një tipar të stilit të Kongolit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3 pikë**➤ **Personaliteti i Inës:****Përgjigje e plotë**

- Ina ka një personalitet të fortë, kurajoz: *Mund të futem?- tha ajo duke ulur prapa kapuçin e pardesysë. Ajo është e dhënë pas Fredit, ka pushtet mbi të dhe e njeh këtë cilësi të vetes (Të prita në bibliotekë plot një orë. Pse nuk erdhe?).*

OSE

- Femër e drejtpërdrejtë dhe lojcake: *S'të pëlqen që erdha?- më pyeti; Ti je kalama,- tha,- përse na qenkan punët kaq të vështira?. Por ajo është edhe natyrë e guximshme dhe e shkathët, spontane: E merr me mend përse kam ardhur?*

OSE

- Natyrë e vendosur: *Jo, sot jo,s'kemi kohë. Tani më dëgjo mirë!Të pëlqen të njihesh me njerëzit e mi?. Tek ajo bie në sy edhe krenaria: Të lutem, në qoftë se bezdisesh, hëpërhë këtë mund ta lëmë.*

Përgjigje e pjesshme

- Ina ka personalitet të fortë.
- Është kurajoze.

2 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të plotë personalitetin e Inës.

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me shembuj nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 **6 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton qëndrimin e vet në lidhje me raportin që duhet të ketë njeriu me të vërtetën;
- përdor detaje mbështetëse të marra nga përvoja personale apo e të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:

hyrjen

zhvillimin

përfundimin

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI **1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.